

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: BO" Global Secyryt&Eurogjici Secyryt&Tony Secyryt&Brecani Rosp sh.p.k&Port Construction"sh.p.k

* * *

Procedura e prokurimit: **E hapur mbi Kufirin Monetar**

Numri i referencës së procedurës/lotit **REF-04498-01-21-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Ruajtja dhe Siguria Fizike me Roje Private dhe Shoqërimi I Vlerave Monetare për UKT sh.a" me fond limit 596 318 469 ,74(pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e katër)lekë pa tvsh

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Arba sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera 0(zero)

K21310002U

numri i NIPT-it

2. BO" Global Secyryt&Eurogjici Secyryt&Tony Secyryt&Brecani Rosp sh.p.k&Port Construction"sh.p.k

K72217015V & K31929010K & K94010201F & K52116005E &L01306513V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 596,314,887,66(pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa tvsh.

3. BO"International Secyryt Albania sh.p.k & Trezhnjeva sh.p.k

L02004016V

&

K19303605O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 596,318,466,74(pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e katër)lekë pa tvsh.

4. SH.P.S.F Snajper Secyurity sh.p.k

K77217701L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 596,318,469,72 (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e dy)lekë pa tvsh.

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Arbana sh.p.k

K21310002U

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 0(zero)

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**Arbana sh.p.k**” nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**Arbana**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. BO"International Secyurity Albania sh.p.k &

Trezhnjeva sh.p.k

L02004016V

&

K19303605O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 596,318,466,74(pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e katër)lekë pa tvsh.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ kapaciteti teknik pika 3.1 ka kërkuar si më poshtë cituar:

3.1 *Operatori ekonomik duhet te paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme për kategoritë e parashikuara për licencat (1.3.A) dhe (1.3.B), të kryera gjatë tri viteve të fundit,(referuar datës së hapjes së tenderit) me vlerë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe përkatësisht 238,527,387, 89 (dyqind e tridhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh.*

Kur shërbimi i ngjashëm i mëparshëm është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. Ose

Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jetë shënuar datat,shuma, lloji i shërbimit të realizuar.

Së pari kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, **përvojën e duhur**, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në përmbushje të kriterit 3.1 mbi paraqitjen e shërbimeve të ngjashme konstatohet se operatori ekonomik “International Secyrity Albania”ka paraqitur kontratat si më poshtë vijon:

1. Kontratën me objekt”Ruajtja e Objekteve dhe Sigurisë Fizike të RTSH-Qarku Tiranë”nr.prot 825,datë 19.03.2016 me vlerë 17,220,190,68(shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e njëzetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë presje gjashtëdhjetë e tetë)lekë pa tvsh.

2.Kontratën me objekt “Ruajtja e Objekteve dhe Sigurisë Fizike të RTSH-Qarku Durrës “nr.prot 361,datë 02.02.2016 me vlerë 12,300,136,2(dy mbëdhjetë milion e treqind mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë presje dy)lekë pa tvsh.

3.Kontratën me objekt”Shërbimi i Ruajtjes dhe i Sigurisë me roje private në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH ,në drejtorinë e Stacioneve Transmetuese RTV në stacionin e TV e FM Dajt në Radiostacionin Shijak dhe Radiostacionin Fllakë”nr.prot 124/5 datë 02.08.2017 me vlerë kontrate 33,176,198,76 (tridhjetë e tre milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë presje shtatëdhjetë e gjashtë)lekë pa tvsh.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit K.V.O konstaton se operatorët ekonomikë kanë paraqitur ne sistemin elektronik kontratën e bashkëpunimit nr.848,281/1 kol datë 13.03.2019 nga të cilët konstatohet se operatori ekonomik “International Secyrity Albania”ka marrë përsipër 55%të kryerjes së shërbimit ndërsa operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k ka marrë përsipër 45% të kryerjes së shërbimit objekt prokurimi.

Gjatë shqyrtimit të kontratës me objekt “Ruajtja e Objekteve dhe Sigurisë Fizike të RTSH-Qarku Durrës “nr.prot 361,datë 02.02.2016 me vlerë 12,300,136,2(dy mbëdhjetë milion e treqind mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë presje dy)lekë pa tvsh konstatohet se kjo kontratë është jashtë afatit të kërkuar në DST si dhe në kundërshtim me rekomandimin e APP datë 20.03.2018 prot 3341/1 .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kjo kontratë nuk do të merret në konsideratë përderisa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në DST.

Theksojmë se kriteri i kërkuar në DST ka qënë i qartë dhe nuk lë vend për paqartësi për operatorët ekonomikë në përgatitjen e dokumentacionit nga ana e tyre.

Nëse operatori ekonomik do të kishte paqartësi mbi vendosjen e kriterit të sipërpërmendur ka pasur momentin procedural të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik në të cilën shprehimisht citohet se....

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Përsa i përket 2 kontratave përkatësisht me nr.prot 825, datë 19.03.2016 dhe kontratës nr.prot 124/5 datë 02.08.2017 vlera totale rezulton në shumën 50,396,389,44(pesëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë presje dyzetë e katër)lekë pa tvsh.

Referuar përqindjes së marrë në kontratën e bashkëpunimit përkatësisht 55% të kryerjes së shërbimit operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur kontrata të ngjashme apo fatura tatimore të realizuara me sektorin privat në vlerën 131,190,063(njëqind e tridhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tre)lekë pa tvsh.

Theksojmë se në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914, datë 29.12.2014”Rregullat e Prokurimit Publik”shprehimisht parashikohet se.... Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Përderisa operatori ekonomik International Secyurity Albania ka marrë përsipër të realizojë 55% të kontratës objekt prokurimi për rrjedhojë duhet të dëshmonte se përmbush vlerën prej 131,190,063(njëqind e tridhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tre)lekë pa tvsh.

Sqarojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor.

Përsa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik International Secyurity Albania do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2/d si më poshtë cituar...

d. Sigurimin e ofertes, (2%) sipas Shtojcës 3.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit KVO konstaton se asnjëri prej operatorëve ekonomikë nuk kanë arritur të paraqesin dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të përcaktuar në DST.

Sqarojmë operatorin ekonomik se në nenin 18 të VKM nr,914, datë 29.12.2014”Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar parashikohet se....

1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t' u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni.

2. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

Duke iu referuar faktit se kjo procedurë objekt prokurimi është mbi kufirin e lartë monetar si dhe njësia e prokurimit ka pëcaktuar qartë në kriteret e veçanta të kualifikimit paraqitjen e këtij dokumentacioni atëherë operatori ekonomik ka qënë i detyruar të paraqesë sigurimin e ofertës në sistemin elektronik si pjesë të dokumentacionit.

Akoma më tej nëse do të kishit pasur, paqartësi në lidhje me këtë kriter, atëherë mbështetur në nenin 42 të ligjit të prokurimit publik, mund të kishte kërkuar sqarime nga autoriteti kontraktor ose të ushtronte të drejtën e tij të ankimit siç parashikohet të nenin 63 të këtij ligji.

Perderisa nuk i ka ushtruar keto te drejta qe i jep ligji , atehere ka qene I detyruar ti plotesonte kriteret per kualifikim sic jane kerkuar ne DT.

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 3.10 si më poshtë cituar...

Per shkak te numrit te madh te punonjesve te sherbimit qe kerkohen ne realizimin e objektit te prokurimit si dhe ne perputhje me Nenit 40, pika 2, te Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit 10237, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", operatori ekonomik duhet te disponoje minimalisht 1 Mjek. Mjeku duhet te figuroje ne lispagesat e shoqërisë.

Per te vertetuar kete kapacitet, operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Kontraten e punes me Mjekun;
- Licencen e Mjekut.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur KVO vëren se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST.

Në shtojcën 8 të DST shprehimisht parashikohet se.....Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. . SH.P.S.F Snajper Secyurity sh.p.k

K77217701L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 596,318,469,72 (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e dy)lekë pa tvsh.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2/d si më poshtë cituar...

d. Sigurimin e ofertes, (2%) sipas Shtojcës 3.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit KVO konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të përcaktuar në DST.

Sqarojmë operatorin ekonomik se në neni 18 të VKM nr,914,datë 29.12.2014”Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar parashikohet se....

1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni.

2.Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

Duke iu referuar faktit se kjo procedurë objekt prokurimi është mbi kufirin e lartë monetar si dhe njësia e prokurimit ka përcaktuar qartë në kriteret e veçanta të kualifikimit paraqitjen e këtij dokumentacioni atëherë operatori ekonomik ka qënë i detyruar të paraqesë sigurimin e ofertës në sistemin elektronik si pjesë të dokumentacionit.

Akoma më tej nëse do të kishit pasur, paqartësi në lidhje me këtë kriter, atëherë mbështetur në nenin 42 të ligjit të prokurimit publik, mund të kishit kërkuar sqarime nga autoriteti kontraktor ose të ushtronte të drejtën e tij të ankimit siç parashikohet të nenin 63 të këtij ligji.

Perderisa nuk i ka ushtruar keto te drejta qe i jep ligji , atehere ka qene I detyruar ti plotesonte kriteret per kualifikim sic jane kerkuar ne DT.

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 3 .1 si më poshtë cituar... *Operatori ekonomik duhet te paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme për kategoritë e parashikuara për licencat (1.3.A) dhe (1.3.B), të kryera gjatë tri viteve të fundit,(referuar datës së hapjes së tenderit) me vlerë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe përkatësisht 238,527,387, 89 (dyqind e tridhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh.*

Kur shërbimi i ngjashëm i mëparshëm është realizuar me institucione shtetërore,Operatori

ekonomik do ta vërtetohet duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyruesisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

Ose

Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetohet këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jetë shënuar datat, shuma, lloji i shërbimit të realizuar.

Së pari kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, **përvojën e duhur**, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në përmbushje të kriterit 3.1 mbi paraqitjen e shërbimeve të ngjashme konstatohet se operatori ekonomik "SH.P.S.F Snajper Secyryty" ka paraqitur kontratat si më poshtë vijon:

1. Kontratën me objekt "Shtesë kontrate" nr. prot 1805, datë 31.12.2015, me vlerë kontrate 278,920 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzetë) lekë pa tvsh.

2. Kontratën me objekt "Shërbim i Ruatjes dhe Sigurisë Fizike me roje private të Gjykatës Mat" nr. prot 213, datë 23.02.2016 me vlerë 403,000 (katërqind e tre mijë) lekë pa tvsh.

3. Kontratën me objekt "Shërbim i Ruatjes dhe Sigurisë Fizike me roje private të Gjykatës Mat" nr. prot 474, datë 29.04.2016 me vlerë 186,465 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

4. Kontratën me objekt "Shërbim i Ruatjes dhe Sigurisë Fizike me roje private të Gjykatës Mat" nr. prot 786, datë 26.07.2016 me vlerë 860,220 (tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë) lekë pa tvsh.

5. Kontratën e nënshkruar me kompaninë "Herbi" sh.p.k datë 31.05.2016 me vlerë kontrate 1,800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh.

6. Kontratën e nënshkruar me kompaninë Teknoxgroup datë 30.12.2016 me vlerë 2,160,000 (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Gjatë shqyrtimit të kontratave me objekt "**Shtesë kontrate**" nr. prot 1805, datë 31.12.2015 dhe **kontratën nr. prot 213, datë 23.02.2016** konstatohen se këto kontrata janë jashtë afatit të kërkuar në DST si dhe në kundërshtim me rekomandimin e APP datë 20.03.2018 prot 3341/1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kjo kontratë nuk do të merret në konsideratë përderisa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në DST.

Theksojmë se kriteri i kërkuar në DST ka qënë i qartë dhe nuk lë vend për paqartësi për operatorët ekonomikë në përgatitjen e dokumentacionit nga ana e tyre.

Nëse operatori ekonomik do të kishte paqartësi mbi vendosjen e kriterit të sipërpërmendur ka pasur momentin procedural të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik në të cilën shprehimisht citohet se....

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Përsa i përket 4 kontratave të cilat rezultojnë brenda afatit të përcaktuar në DST vlera totale

rezulton në shumën 5,006,685(pesë milion e gjashtë mijë e gjashtëqind e tëtëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.

Në rastin konkret, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se kontratat e paraqitura si shërbim i ngjashëm në procedurën e prokurimit, nuk përmbush vlerën e përcaktuar në DST si dhe kontratat e paraqitura me institucionin e Gjykatës së Rrethit gjyqësor rezultojnë të pashoqëruara me vërtetimin e realizimit çka bie në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme per te percaktuar oferten fituese ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Pra,përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 3.10 si më poshtë cituar...

Per shkak te numrit te madh te punonjesve te sherbimit qe kerkohen ne realizimin e objektit te prokurimit si dhe ne perputhje me Nenit 40, pika 2, te Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit 10237, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", operatori ekonomik duhet te disponoje minimalisht 1 Mjek. Mjeku duhet te figuroje ne lispagesat e shoqërisë. Per te vertetuar kete kapacitet, operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Kontraten e punes me Mjekun;
- Licencen e Mjekut.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur KVO vëren se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST.

Në shtojcën 8 të DST shprehimisht parashikohet se.....Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. BO" Global Secyryity&Eurogjici Secyryity&Tony Secyryity&Brecani Rosp sh.p.k&Port Construction”sh.p.k

K72217015V & K31929010K & K94010201F & K52116005E &L01306513V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 596,314,887,66(pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e katërmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a,Drejtoria e Prokurimeve brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.03.2019

Ankesa: **JO**

